



Pranuar / Doretuar Prijemni/Produeto Received/Delivered	27-07-2023	viti god year	
Organ /Njesia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKM/SHCK	5374	2023	115



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.841/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari- kryetare Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtar, si dhe Ilire Mehmeti-Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.841/2023 të datës 13.06.2023, të parashtruar nga ankuesi, me adresë banimi në
,kundër organit të punësimit, Komuna e Gjakovës, në çështjen juridike "Kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datën 27.07.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.841/2023, e datës 13.01.2023 e parashtruar nga ankuesi
- II. Mbetet në fuqi Vendimi nen shenjen RAN0012509 i datës 15.05.2023 i Kryesuesit të Komisionit të Vlerësimit për Ngritje në Detyrë në Komunën e Gjakovës.

A r s y e t i m

Komuna e Gjakovës me datë 28.03.2023 ka njoftuar për shpalljen e konkursit me numër referencës RN00011319 për ngritje (avancim) në detyrë për pozitën Udhëheqës i Sektorit për Regjistrimin e Bizneseve, ku afati për aplikimin ka qenë nga data 12.04.2023 deri më datë 19.04.2023. Në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesi i cili i është nënshtruar fazave të procedurës.

Bazuar në rendjen përfundimtare të kandidatëve të datës 08.05.2023, ankuesi është vlerësuar me gjithsej 67 pikë, respektivisht në testin me shkrim është vlerësuar me 37 pikë, në vlerësimin e jetëshkrimit me 20 pikë ndërsa në intervistë me gojë është vlerësuar me 10 pikë dhe është renditur

i dyti me pikë, ndërsa ankuesi më datë 08.05.2023 është njoftuar përmes emalit nga SIMBNJ për publikimin e rezultateve të vlerësimit.

Ankuesi më datë 10.05.2023 ka parashtruar ankesë në Komisionin e Vlerësimit për Ngritje në Detyrë, ndërsa ky i fundit përmes Vendimit RAN0012509 të datës 15.05.2023 ka refuzuar si të pabazuar ankesën e ankuesit.

Ankuesi kundër vendimit RAN0012509 të datës 15.05.2023 të Komisionin e Vlerësimit për Ngritje në Detyrë me datën 13.06.2023 ka parashtruar ankese me numër protokollit 4727/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me pretendimet ankimore, se Komisioni Vlerësues në Komune e Gjakovës me rastin e marrjes së vendimit me numër RAN0012509 të datës 15.05.2023 ka bere vërtetim të gabuar të gjendjes faktike, shkelje esenciale të dispozitave ligjore si dhe aplikim të gabuar të së drejtës materiale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave me datë 16.06.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Komunën e Gjakovës , ndërsa kjo e fundit më datë 21.06.2023 ka përcjell në Këshill provat lidhur me çështjen për shqyrtim dhe vendosje.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, më rastin e vendimmarrjes sa i përket kësaj ankese ka administruar këto prova; Ankesën me numër të protokollit 4727/2023 të datës 13.06.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Konkursin me numër reference RN00010993 të datës 13.02.2023; Listën e datës 24.04.2023 lidhur me verifikimin paraprak për pozitën "Udhëheqës i Sektorit për Regjistrimin e Bizneseve"; Ankesën e datës 10.05.2023 të parashtruar nga ankuesi në Zyrën e Personelit në Komunën Gjakovës; Certifikatën e datës 04.11.2014; Diplomën e datës 05.12.2019; Njoftimin e datës 25.09.2012; Certifikatën lidhur me përfundimin e trajnimit "Advanced of Participation"; Certifikatën lidhur me përfundimin e trajnimit të stafit ARBK-së për përdorimin e platformës elektronike për regjistrimin e bizneseve" me periudhe kohore prej 30.09.2020 deri me 01.10.2020; Certifikatën e datës 05.03.2010; Akt emërimin nën shenjen A.E. Nr. 11-122/AL37878 të datës 16.12.2021; Shkresën (pjesë të shkëputur nga gazeta) të datës 29.05.2023; Njoftimin e SMBNJS të datës 04.05.2023; Përgjigjen në kërkesë me numër 01-034/01-9922 të datës 26.05.2023; Njoftimin me numër RN00011319 të datës 08.05.2023; Rezultatit e vlerësimit për pozitën "Udhëheqës i Sektorit për Regjistrimin e Bizneseve" ; Vendimin me numër RAN0012509 të datës 15.05.2023; ID e ankuesit; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 16.06.2023; Përgjigjen në ankesë të datës 16.06.2023; Konkursin me numër të referencës RN00011319 të datës 28.03.2023; Vendimin me numër 01-112/02-7000 i datës 03.04.2023; Emalin e datës 28.03.2023 të drejtuar Listën e aplikantëve me numër të Referencës RN00011319; Aplikacionin e ankuesit të datës 12.04.2023; Dokumentin e identifikimit; Certifikatën lidhur me pjesëmarrjen në trajnimin "Korniza e Përbashkët e Vete- Vlerësimit (KPV) Dhjetor-2015; Certifikatën lidhur me përfundimin e kursit të kompjuterëve për periudhën kohore 17.09. derri me 23.12..2002; Certifikatën lidhur me përfundimin me suksese të kursit dy javor " Themelimi i Qendrave Komunale të Biznesit, financiar nga Banka Botërore" e datës 05.03.2010; Vërtetimin e marrëdhënies së punës me numër Nr.112/118/2023 të datës 28.02.2023; Certifikatën me Nr. 164/2010 të datës 27.04.2010; Formularin për Vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të Shërbimit Publik për Kategorinë Drejtuese

i mesëm i ulet dhe profesional i datës 11.01.2023; Formularin për Vlerësimin e Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike për kategorinë Drejtues i Mesës i Ulet dhe Profesional i datës 15.01.2021; Aplikacionin e datës 13.04.2023 të kandidatit të përzgjedhur; Diplomën me Nr.6540 të datës 01.10.2019 me të cilën dëshmohet se kandidati ka fituar titullin Jurist i diplomuar; Certifikatën me numër 07/02 të datës 11.02.2016; Aktin e emërimit nën shenjën A.E.Nr.01-112/02-12699 të datës 21.05.2021; Vërtetimin e marrëdhënies së punës me numër 112/233/2022 të datës 14.10.2022; Dokumentin e identifikimit; Formularin për Vlerësimin e Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe nëpunësve të Shërbimeve Publike për Kategorinë Drejtues i Mesëm i Ulet dhe Profesional të datës 30.01.2022; Formularin për Vlerësimin e Rezultateve në punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike për Kategorinë Drejtues i Mesëm, i Ulet dhe Profesional i datës 21.01.2021; Vërtetimin me numër 11/234/2022 të datës 14.10.2022 me të cilën dëshmohet se kandidati D.N nuk ka ndonjë masë disiplinore; Renditjen përfundimtare të kandidateve të datës 08.05.2023 të publikuar në SMBNJ; Emalin e datës 08.05.2023 të drejtuar Njoftimin me numër RN00011319 të datës 08.05.2023 me rezultatin nga faza e vlerësimit, pozita "Udhëheqës i Sektorit për Regjistrimin e Bizneseve" Emalin e datës 08.05.2023 të drejtuar Ankesën e datës 10.05.2023; Dëshmi lidhur me anëtarët e familjes si dëshmor; Diplomën me numër 81/19 të datës 05.12.2019; Vendimin me RAN0012509 të datës 15.05.2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e pa bazuar, sepse:

Në bazë të konkursit me numër referencës RN00011319 për ngritje (avancim) në detyrë për pozitën Udhëheqës i Sektorit për Regjistrimin e Bizneseve, kriteret e përcaktuar kanë qenë: *"Arsimi i kërkuar: Diplomë/a të studimeve universitare së paku 3 vite studimeve në Ekonomik, Biznes ose Administratë Publike. Përvoja e punës e kërkuar: Së paku pesë (3) vite përvojë punë profesionale"*.

Kolegji i Këshillit, me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së procesit për ngritje (avancim) në detyrë për pozitën Udhëheqës i Divizionit për Mbikëqyrjen dhe Zbatimin e Legjislacionit, ka gjetur se në konkursin në fjalë, sipas renditjes përfundimtare të kandidatëve të datës 08.05.2023 lidhur me konkursin për pozitën, "Udhëheqës i Sektorit për Regjistrimin e Bizneseve" me numër reference RN00011319 ankuesi është renditur i dyti në listë me gjithsej 67 pikë i cili në testin me shkrim është vlerësuar me 37 pikë, në vlerësimin e jetëshkrimit me 20 pikë ndërsa në intervistë me gojë është vlerësuar me 10 pikë, ndërsa kandidati i përzgjedhur, në testin me shkrim ka arritur gjithsej 57 pikë në vlerësimin e jetëshkrimit 14 pike dhe në intervistën me gojë 9 pikë respektivisht me gjithsej 80 pikë të përgjithshme. Andaj Kolegji i Këshillit lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit se Komisioni nuk e ka shqyrtuar drejt ankesën e ankuesit të datës 10.05.2023 lidhur me vlerësimin e kandidateve në konkursin e datës 28.03.2023 është i pa qëndrueshëm sepse në bazë të shkresave të lëndës Kolegji ka gjetur se Komisioni i Vlerësimit në vendimin e datës 15.05.2023 i është përgjigjur ankuesit se në testimin me shkrim mbahet në mënyrë elektronike, sistemi i procedurës rezultatin në mënyrë elektronike tek kandidati pak minuta pas përfundimit të testit duke i siguruar anonimitetin e konkurrentëve dhe duke i mundësuar që rezultatin e testit ta shoh vetëm kandidati, ndërsa në vlerësimin e jetëshkrimit dhe intervistës me gojë ankuesi nga ana e Komisionit është vlerësuar me piket maksimale, prandaj pretendimi se ankesa e ankuesit nuk është shqyrtuar drejtë nga ana e Komisionit të vlerësimit nuk është e bazuar.

Tutje, Kolegji i Këshillit pas analizimit të formularëve të vlerësimit të ankuesit dhe kandidatit të përzgjedhur ka gjeture se të dy kandidatet kanë plotësuar kriteret e konkursit, ashtu siç ka përcaktuar edhe Rregullorja (QRK) Nr.16/2020 për Pranimit dhe Karriere në Shërbim Civil të Republikës së Kosovës, kështu që mbi këtë konstatim Kolegji vlerëson se Njësia e Burimeve Njerëzore ka vepruar në pajtim me nenin 49 paragrafi 2 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimit dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës më të cilin është përcaktuar se: *“Kandidati që është vlerësuar me më shumë pikë dhe që ka marrë të paktën gjashtëdhjetë (60) pikë është kandidati fitues dhe ka të drejtën të emërohet në pozitën e lirë për të cilën është zhvilluar konkurrimi...”*, rrjedhimisht sipas kësaj dispozite Kolegji ka konstatuar se kandidatet që marrin pikë më shumë emërohen në pozitën përkatëse e në rastin konkret kandidati i përzgjedhur është vlerësuar me trembëdhjetë (13) pikë më shumë se ankuesi.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me RAN0012509 të datës 15.05.2023 të Komisionit të Vlerësimit për Ngritje në Detyrë në Komunën e Gjakovës, pretendon se Komisioni Vlerësues për Zhvillimin e procedurës në komunën e Gjakovës për pozitën e punës *“ Udhëheqës i Sektorit për Regjistrimin e Bizneseve”* lidhur me ankesën e parashtruar pranë këtij Komisioni me datën 10.05.2023 është vendosur pa mbajtur seance dëgjimore e cila është në kundërshtime me Rregulloren NR.05/2011 për Procedurat e Zgjedhjes së Kontesteve dhe Ankesave. Kolegji pasi ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit dhe duke u bazuar në shkresat e lëndës ka konstatuar se konkursi për pozitën *“Udhëheqës i Sektorit për Regjistrimin e Bizneseve”*, i shpallur me datën 28.03.2023 është shpallur duke u bazuar në nenin 39 paragrafi 1,2 dhe 3 të Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, si dhe rregulloren (QRK) Nr.16/2020 për pranimit dhe Karrierën në Shërbim Civil ndërsa dispozitat në të cilat ankuesi është bazuar nuk janë në fuqi sepse Rregullorja Nr.05/2011, është shfuqizuar sipas Rregullores (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë respektivisht neni 20 i kësaj rregullore ka specifikuar se: *„ Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje shfuqizohen Rregullorja Nr. 04/2011 për Procedurën Disiplinore në Shërbimin Civil si dhe Rregullorja nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjedhjes së Kontesteve dhe Ankesave*, që nënkupton se me rastin e shpalljes së këtij konkursi nuk ka qenë në fuqi Ligji Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil e as Rregullorja NR.05/2011 për Procedurat e Zgjedhjes së Kontesteve dhe Ankesave, andaj pretendimi ankimor i ankuesit është i pa bazuar.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se Komisioni i Vlerësimit për Ngritje në Detyrë në Komunën e Gjakovës, me rastin e nxjerrjes së Vendimit të datës 15.05.2023 përmes të cilit është refuzuar ankesa e ankuesit, ndërsa ka lënë në fuqi Njoftimin e datës 08.05.2023 të publikuar nga Njësia e Burimeve Njerëzore në Komunën e Gjakovës ka vepruar në pajtim me nenin 39 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë sikurse edhe nenin 62 dhe 63 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimit dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, dhe po ashtu ky vendim i goditur përmes kësaj ankese përmban elementet e aktit administrativ, ndërsa arsyetimi i tij është në pajtim me nenin 47 dhe nenin 48 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, pasi që kanë vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike ngase pretendimet ankimore të ankuesit janë të pabazuara në dispozitat e ligjit material dhe akteve nënligjore që rrjedhin prej tij, si rezultat i kësaj Kolegji i Këshillit, meqenëse nuk ka evidentuar ndonjë shkelje procedurale në këtë procedurë, atëherë në kuptim të dispozitave ligjore në fuqi për zyrtarët publikë, kjo procedurë konsiderohet e ligjshme, rrjedhimisht sa i përket kësaj procedure është vepruar në

pajtim me parimet e përcaktuar me nenin 6, nenin 39 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës lidhur me procedurën e ngritjes (avancimit) në detyre, kështu që të gjitha pretendimet e ankuesit janë të pabazuara.


Theksuar i më lart, e duke bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.


Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda. A.nr. 841/2023.

Ilire **MEHMETI-SHAQIRI**


Procesmbajtëse

Malsore **GASHI-BAJRAKTARI**


Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Gjakovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.